



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore kundër Isni Kilajt, versioni publik i redaktuar i vendimit të Gjykatësit të Vetëm, të datës 9 nëntor, tani është i disponueshëm në faqen e internetit të DHSK-së. Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ekziston dyshim i bazuar se pjesë të materialeve të sekuestruara nga Zyra e Prokurores së Specializuar ose synohej të përdoshin, ose ishin përdorur në fakt për të ndërhyrë në administrimin e drejtësisë, dhe se z. Kilaj mund të jetë përfshirë në kryerjen e një veprë penale në kuadër të juridiksionit të DHK-së.

Për rrjedhojë, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që z. Kilaj mund të arratiset, të pengojë kryerjen e procedurave, ose të kryejë vepra penale të tjera. Gjykatësi konstatoi gjithashtu se kushtet për lirim të përkohshëm, të propozuara nga Mbrojtja e z. Kilaj, janë të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun që ai të pengojë procedurat dhe të kryejë vepra penale të tjera, dhe rrjedhimisht urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj.

Këtë javë u bënë publike një numër parashtrimesh lidhur me arrestimin dhe transferimin e z. Kilaj, ndër to, raporti i Zyrës së Prokurores së Specializuar për arrestimin dhe transferimin e z. Kilaj dhe raporti i Administratores për transferimin e z. Kilaj në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjykses miratoi më 13 nëntor kërkesën e Prokurorisë dhe të Mbrojtjes për të pranuar në prova dokumente të përdorura gjatë dëshmisë së katër dëshmitarëve në sallë të gjyqit. Seancat në çështjen gjyqësore *Shala* rifillojnë të hënën e ardhshme, 20 nëntor, dhe ato janë planifikuar të mbahen nga e hëna në të premte gjatë dy javëve të ardhshme.

Në çështjen gjyqësore kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, më 8 nëntor dolën versionet publike të redaktuara të raportit të Administratores drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake për arrestimin dhe transferimin e z. Januzi dhe z. Bahtijari.

Në çështjen gjyqësore z. *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, dëshmitari i 35-të i thirrur nga Prokuroria, i cili pretendohet se ishte arrestuar dhe keqtrajtuar nga anëtarë të UÇK-së, dha dëshmi të enjten e kaluar dhe këtë të hënë, më 9 dhe 13 nëntor.

Të hënën, 13 nëntor, z. Sadik Halitjaha, dëshmitari i 36-të, filloi dhënien e dëshmisë. Sipas përmbledhjes së lexuar në sallën e gjyqit nga Prokuroria, ky dëshmitarë ishte epror në UÇK, i cili kishte pozita të ndryshme gjatë periudhës përkatëse.

Këtë javë, të martën dhe të mërkurën, z. Shefqet Kabashi, dëshmitari i 37-të i thirrur nga Prokuroria në këtë çështje gjyqësore, dha dëshmi nëpërmjet videolidhjes.





Pas përfundimit të dëshmisë së z. Kabashi, z. Halitjaha, dëshmitari i 36-të, vazhdoi dje dhe sot dhënien e dëshmisë që e kishte filluar më parë.

Në përputhje me kornizën ligjore të DHSK-së, ekipet e Mbrojtjes mund të marrin në pyetje dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria, dhe Mbrojtësi i Viktimave dhe gjykatësit e Trupit Gjykues gjithashtu mund t'i marrin ata në pyetje.

Seanca e radhës në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* është planifikuar të mbahet më 4 dhjetor 2023.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 15 nëntor, Trupi Gjykues urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në vendime të ndara, gjykatësit konstatuan se vazhdon të ekzistojë rreziku që të dy të akuzuarit të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë krime të tjera kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së, ndër të cilët dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi apo që mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që priten të paraqiten para gjykatës. Trupi Gjykues konstatoi gjithashtu se komunikimet mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së.

Më 9 nëntor, Trupi Gjykues miratoi pjesërisht kërkesën e Zyrës së Prokurores së Specializuar për të pranuar në prova transkriptet e intervistave dhe deklaratat të mëparshme të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe pranoi në prova, ndër të tjera, disa intervista të Prokurorisë me z. Thaçi dhe z. Selimi, dhe disa deklaratat dhe dëshmi dëshmitari të nga të katër të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

